

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ Premium Import “ SH.P.K**

Sot, më datë 15/02/2023 (dymije e njezete e tre), u paraqiten shtetasit e meposhtem:

**THEMELUES/IT:**

Artur Sinani, atësia Astrit, amësia Lutfije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, lindur më 08/02/1966, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me me Leternjoftim ID nr. personal G60208052R.

**THEMELUES/IT:**

Mateo Sinani, atësia Artur, amësia Aurela, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane lindur më 17/07/1997, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. personal J70717046O, .

I cili ne cilesine e themeluesit me kerkoi hartimin e ketij akt themelimi, nepermjet te cilit me deklaroi se me vullnet të lire e të plote dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ne ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne Ligjin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, “ Premium Import “ SH.P.K.

**KREU 1**

**Neni 1  
Krijimi**

Shoqeria, “Premium Import” SH.P.K eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “ Premium Import” shpk, eshte nje shoqeri, kapitali i së cilës ndahet në PJESE dhe që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 3  
Selia**

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Mjull Bathore, Rruga Ramazan Topoja, Elysium Residence, Godina nr 20, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 4**



### **Objekti i veprimtarise :**

**Objekti i veprimtarise te kesaj shoqerie eshte:** Import-Export, Transport, bar kafe, restorant, shitje me shumice ose pakice etj. Shoqeria mund te kryej gjithashtu cdo veprim tregtar, biznesi, industrial apo financiar me qellim arritjen e objektive te aktivitetit tregtar te shoqerise.

### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themelues i shoqerise 100 (njeqind leke), te kontribuar nga ortaket e shoqerise;

- *Artur Sinani 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise ne vleren 50 Leke (pesedhete leke)*
- *Mateo Sinani 50% te kuotave kapitalit te shoqerise ne vleren 50 Leke (pesedhete leke)*

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme kapitali mund te rritet sipas formave te parashikuara nga ligji.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve, deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë pergjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqerise për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU II**

### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Pergjithshme dhe administratori jane organet vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme, vendos për çështje si :



- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 10**

#### **Administrimi**

Administrimi i shoqërisë do të behet nga 1 (një) administrator i cili është:

Administrator i shoqërisë emërohet: Z. Mateo Sinani, atësia Artur, amësia Aurela, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë lindur më 17/07/1997, , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. personal J70717046O, për një periudhë 5 vjeçare.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 11**

#### **Kompetencat**

Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve. Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakeve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktoshin në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

### **Neni 12**

#### **Viti Financiar**



Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 13

#### Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji “ Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare”
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

### Neni 14

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

### Neni 15

#### Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 16

#### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi eshte hartuar ne 2 kopje me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen shqipe, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare “Premium Import“ sh.p.k., nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

### ORTAKET

Artur Sinani

Artur Sinani



Mateo Sinani

Mateo Sinani

